



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 447 prot.

Pukë, më 13.03. 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 5 datë 13.03. 2026

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË

Z. GJON BERISHA

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Keshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me datë \_\_\_\_\_.03.2026;

Vendosi:

1. T'i akordojë titullin “QYTETAR NDERI” i Bashkisë Pukë.

Z. GJON BERISHA

Me motivacionin:

*“Për kontributin e shquar humanitar dhe kombëtar në mbështetje të çështjes shqiptare, për ndihmën e vazhdueshme ndaj familjeve në nevojë, arsimit, kulturës dhe institucioneve shoqërore në Shqipëri dhe Kosovë, si dhe për rolin e tij aktiv në mbështetjen e zhvillimeve demokratike dhe përpjekjeve për liri e pavarësi të Kosovës, duke dëshmuar gjithmonë vlerat e solidaritetit, atdhedashurisë dhe fisnikërisë së traditës pukjane.”*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.

Paraqitën projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.

Sokol Gjoni

Juristi

Aida Sinani

Kryetari

Rrok Dodaj



## Biografi e shkurtër

Z. Gjon Berisha

I lindur, me 22 shkurt 1956

Fshati Orize

Gjakovë

Gjon Berisha, me origjinë nga Berisha e Pukës, ka lindur në fshatin Orize, i cili gjendet ngjitur me fshatin Meje të Gjakovës, aty ku me 27 prill 1999, ka ndodhur masakra më e madhe serbe në Kosovë.

Forcat serbe atë ditë të përgjakëshme vranë 380 civil shqiptar, në mesin e të cilëve fëmijë, gra dhe të moshuar.

Gjon Berisha shkollen fillore 8 vjeqare e kreu në fshatin Brekoc të Gjakovës.

Babai i Gjonit, Zef Berisha, duke qenë djal i vetëm i një burri të shquar Malsor e Pukjan, Mushak Hajdari, ishte i pëndjekur nga regjimi i Serbisë dhe i ish Jugosllavisë. Zefi për të iu shpëtuar përndjekjeve dhe gjendjes së vështirë familjare arratiset në Shqipërinë e Enver Hoxhes dhe si shume shqiptar të tjerë nga Kosova, të cilët arratiseshin ilegalisht në Shqipëri, regjimi komunist e dergoj për afër 10 vjet në kampet i internimit.

Gjoni fëmijërinë e kaloi me gjyshin dhe nënën, në skamje dhe varfëri, si dhe i vëzhguar nga pushteti dhe regjimi policor serbo-jugosllav.

I gjendur në një situatë të vështirë për ekzistencë, në moshën 15 vjeqare, Gjoni largohet nga Kosova dhe vendoset për të punuar në Austri, ku punoi punë të rëndë dhe të frikëshme për moshën e tij të njomë, si varrhapës në varrezat në periferi të Vjenes.

Nga Austria ai transferohet me punë dhe qëndrim në Gjermani dhe për shumë vite nuk mundi të kthehej në Kosovë, sepse nuk dëshironte ta kryente dhe kurrë nuk e kreu shërbimin ushtarak në armatën serbo-jugosllave sepse mund të arrestohej.

Nga Gjermania kujdesej për mirëqenjen e familjes dhe të afërmeve të tij në Gjakovë, pasi që fillimisht u punësua në portin e madh të Hamburgut e më pastaj u mor me gastronomi kurse më vonë e hapi kompaninë e tij imobiliare dhe të ndertimtarisë, e cila si e tillë arriti të kishte mbi 250 puntorë nga Gjermania, Polonia, Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia.

Me forcimin e gjendjes ekonomike humaniste dhe filantropi Gjon Berisha filloi mbështetjen e familjarëve, miqëve dhe nevojtarëve, por edhe të segmenteve të arsimit, kultures, politikës, shëndetësisë dhe informimit në Shqipëri dhe Kosovë.

Me ndërhyrjen brutale të Serbisë në Kosovë dhe heqjen e autonomise politike të Kosovës, në vitin 1989, kur forcat serbe bënë invazion në Kosovë, duke larguar punëtorët shqiptar nga puna, nga shëndetësia, arsimi, policia dhe ekonomia, Gjoni ishte inkuadruar me të gjithë qenjen e tij në mbështetjen e zhvillimeve në Kosovë por edhe të gjendjes së rëndë të Shqipërisë së viteve 1990.

Ai mori kontakte me pothuaj të gjithë liderët politik të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, si Pjetër Arbnori, Sali Berisha, Edi Rama, Fatos Nano, Ilir Meta, Zef Bushati, Xhezair Zaganjori, Ylli Pepo nga RTSH, pastaj me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë, si dhe zyrtar të tjerë të Shqipërisë, të cilët i takonte në Tiranë, apo ata i priste në villen e tij të pagëzuar Villa Berisha Albania, në Hamburg të Gjermanisë, e cila ishte strehe apo si një "ambasade" shqiptare e qindra politikanve, veprimtarëve, intelektualëve dhe misionarëve të çështjes kombëtare.

Gjon Berisha poashtu takonte dhe i mbështeste në aktivitetet e tyre politike dhe diplomatike ish zyrtarët kosovar të dekadave të para dhe gjatë luftës, si presidentin e Kosovës Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Bujar Bukoshi, Isa Mustafa, Anton Qetta, Mark Krasniqi, Gjergj Dedaj, Lazer Krasniqi, vëllëzerit altruist e atdhetar Simon e Mikel Kuzhnini, Hoxhë Idriz Kokrruki, Ipeshkvët Mark Sopi e Don Lush Gjergji, sepse Gjoni ishte mbështetës i veçantë pa dallime dhe ngjyrimet politike, ideologjike apo fetare.

Gjon Berisha nuk u ndal kurrë qoftë në punët dhe angazhimet e tija ditore të afarizmit dhe biznesit të tij, por krahas kësaj ai kurrë nuk tha jo dhe nuk pushoj për të qenë sa më afër familjes, miqëve, njerzve në nevojë, të sëmuar dhe atyre të cilët ishin në mision të lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës si dhe të demokratizimit të Shqipërisë poskomuniste.

Me rastin e fillimit të luftës së armatosur në Kosovë, ndërmjet UÇK dhe forcave serbe të Millosheviqit, 1998/1999, me çrast vriteshin mijëra shqiptar të Kosovës, siq dihet ndodhi në vendlindjen e Gjonit edhe masakra e madhe në Meje të Gjakovës në pranverën e vitit të përgjakshëm 1999, kur edhe filloj terrori, vrasjet dhe spastrimi i dhunshëm etnik i qindra mijëra kosovarëve, të cilët ia mësyen Maqedonisë dhe Shqipërisë, e cila i hapi zemrat dhe shtëpitë për vëllëzërit nga Kosova, Gjoni u kthi në Shqipëri, duke i kërkuar të afërmit dhe takuar ata të cilët kishin nevojë financiare për të jetuar dhe levizur e të cilët i ndihmoj të gjithë ata nevojtar, duke përfshirë edhe shumë pjesëtar të UÇK-së.

Me të përfunduar lufta Gjoni kthehet në Kosoven e djegur dhe të shkatërruar nga lufta, për të ndihmuar sanimin e pasojave të luftës heroike të popullit të Kosovës. Me rastin e transformimit të UÇK në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, TMK, Gjoni organizoj bashkëatdhetarët në Hamburg për të ndihmuar TMK me veshëmbathje dhe pajisje tjera të nevojshme.

Ndër vlerat dhe virtytet unike dhe të veqante të Gjon Berishes është se ky kurrë nuk ka kërkuar ti kthehen në asnjë mënyrë ato ndihma të shumta që ka dhënë, madje as ti përmenden, duke mos kërkuar shpërblim dhe asnjë privilegj për kontributin e tij historik ngase të gjitha të arriturat dhe sukseset e tij i ka arritur me punë të pandalur në Gjermani, pa këkuar asgjë nga Shqipëria dhe Kosova.

Jane disa miq dhe njerz të tjerë të cilët sepaku nuk e kanë harrur kontributin e tij kolosal, duke e nderuar me ndonjë falenderim, mirënjohje dhe respekt për ta provokuar heshtjen dhe modestinë të tij prej virtytit të Malsorit Pukjanë, i cili ndjehet shumë mirë kur të tjerët ndjehen mirë dhe kur mundet sadopak të ndihmoj nevojtarin, kalimtarin dhe lajmetarin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 4047/1 prot.

Pukë, më 13.03 2026

RELACION  
PËR PROJEKTVENDIMIN "PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI' TË  
BASHKISË PUKË, Z. GJON BERISHA"

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë Pukë,

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, konkretisht nenit 9, pika 1.7 dhe nenit 54, germa "m", të ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", si dhe të VKM nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", paraqitet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Bashkisë Pukë projektvendimi për dhënien e titullit "**Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë**" për z. **Gjon Berisha**.

Gjithashtu, projektvendimi mbështetet edhe në **VKB nr. 71, datë 27.12.2024**, "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor për titujt vendorë të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre", e cila përcakton kriteret dhe procedurat për vlerësimin e personaliteteve që kanë dhënë kontribut të veçantë në jetën shoqërore, kulturore, humanitare dhe kombëtare.

Dhënia e titujve vendorë të nderit përbën një nga format më të rëndësishme të vlerësimit institucional që një komunitet u bën individëve të cilët, përmes veprimtarisë dhe angazhimit të tyre, kanë kontribuar në mënyrë të spikatur në shërbim të shoqërisë, të interesit publik dhe të vlerave kombëtare.

Në këtë kuadër, figura e z. **Gjon Berisha**, me origjinë nga Berisha e Pukës, përfaqëson një personalitet të respektuar dhe të vlerësuar për kontributin e tij të gjatë në mbështetje të komunitetit shqiptar, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.

Pavarësisht vështirësive të mëdha që shoqëruan jetën e tij që në fëmijëri, ai arriti të ndërtojë me punë dhe përkushtim një aktivitet të suksesshëm biznesi në Gjermani, duke u bërë një sipërmarrës i suksesshëm dhe duke krijuar mundësi punësimi për shumë qytetarë shqiptarë dhe të huaj.

Krahas veprimtarisë së tij ekonomike, z. Gjon Berisha është dalluar për angazhimin e vazhdueshëm humanitar dhe për mbështetjen e dhënë ndaj familjeve në nevojë, arsimit, kulturës, institucioneve shoqërore dhe zhvillimeve demokratike në hapësirën shqiptare.

Gjatë periudhave të rëndësishme historike për kombin shqiptar, veçanërisht në vitet e vështira të zhvillimeve politike në Kosovë dhe gjatë luftës për liri e pavarësi, ai ka qenë një mbështetës aktiv i përpjekjeve për çështjen kombëtare, duke ndihmuar me përkushtim bashkëkombësit dhe institucionet që vepronin në funksion të lirisë dhe demokracisë.

Kontributi i tij humanitar dhe kombëtar është shtrirë në ndihmën ndaj familjeve në nevojë, mbështetjen e institucioneve arsimore, kulturore dhe shoqërore, si dhe në përkrahjen e iniciativave që lidhen me forcimin e identitetit dhe solidaritetit kombëtar.

Propozimi për dhënien e këtij titulli është shqyrtuar edhe nga **Komisioni Këshillimor për Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Bashkinë Pukë**, i cili, në përputhje me rregulloren përkatëse, ka dhënë miratimin për vijimin e procedurës për dhënien e këtij vlerësimi.

Në këtë kuadër, dhënia e titullit **“Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë”** për z. **Gjon Berisha** përbën një akt mirënjohjeje dhe respekti institucional ndaj kontributit të tij humanitar, kombëtar dhe shoqëror, si dhe një vlerësim për figurën e tij që përfaqëson me dinjitet vlerat e solidaritetit, atdhedashurisë dhe traditës pukjane.

Për sa më sipër, propozohet që **Këshilli i Bashkisë Pukë** të shqyrtojë dhe të miratojë projektvendimin “Për dhënien e titullit ‘Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë’ për z. Gjon Berisha”.

Bashkëlidhur:

1. PROJEKT VENDIMI, Nr. 05, datë 13.03.2026


PËR DHËNIEN E TITULLIT ‘QYTETAR NDERI’ I BASHKISË PUKË Z. GJON BERISHA

2. Miratimi i Komisionit Këshillimor.

3. Biografi e shkurtër

**DREJTORI I DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**SOKOL GJONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
KOMISIONI KËSHILLIMOR PËR MEDALJET DHE TITUJT VENDOR TË NDERIT

Pukë, më 13.03.2026

Nr. 4427 prot.



MIRATIM

PËR DHËNIEN E TITULLIT ‘QYTETAR NDERI’ I BASHKISË PUKË

Z. GJON BERISHA

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, si dhe VKB nr.70, datë 27.12.2024, “Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendor të nderit në Bashkinë Pukë”; pasi u njohëm me materialet dhe dosjen e plotë, përmes së cilës dokumentohet roli i Z. Gjon Berisha, si *kontribues i shquar humanitar dhe kombëtar në mbështetje të çështjes shqiptare, ndihma e tij e vazhdueshme ndaj familjeve në nevojë, arsimit, kulturës dhe institucioneve shoqërore në Shqipëri dhe Kosovë, si dhe roli i tij aktiv në mbështetjen e zhvillimeve demokratike dhe përpjekjeve për liri e pavarësi të Kosovës*, shprehemi unanimisht për vlerësimin e tij të merituar nga Bashkia Pukë si “Qytetar Nderi”,

KOMISIONI KËSHILLIMOR

1. Sokol Gjoni 
2. Denisa Meçi \_\_\_\_\_
3. Endrit Kraja 
4. Rasim Laçi \_\_\_\_\_
5. Ylli Hadroj \_\_\_\_\_